

Përgjigje nga Bashkia Tiranë shkresës me nr. prot. 1376/1, datë 23.08.2023

From: E Drejta Per Informim (edrejtaperinformim@tirana.al)

To: medialook@yahoo.com

Cc: info@idp.al

Date: Tuesday, 29 August 2023 at 13:36 CEST

Përshëndetje,

Në vijim të shkresës suaj me nr. 1376/1 prot., datë 23.08.2023 me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë (në vijim “Autoriteti Publik”) protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 29458 prot., datë 23.08.2023 dhe kërkesës fillestare dërguar nga z. Luku pranë Bashkisë Tiranë dhe protokolluar me nr. prot. Q-16020, datë 27.07.2023, ju bëjmë me dije se ka përgjigje si vijon:

“Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të Qendrës Shqiptare MediaLook ju bëjmë me dije se :

Bashkia e Tiranës ka qënë dhe është gjithmonë e hapur për çdo ndërveprim/komunikim me median, duke besuar në nevojën për të përçuar informacion për publikun, por edhe për të bërë transparencë për punën e saj. Aktivitetet e saj janë publike dhe të hapura për pjesëmarrjen e gazetarëve dhe mediave si dhe për pasqyrimin e tyre në platformat e ndryshme mediatike.

Zyra e Shtypit në Bashkinë e Tiranës është në kontakt të përditshëm dhe informon të gjitha mediat e interesuara për të gjitha aktivitetet e Bashkisë së Tiranës apo Kryetarit të Bashkisë Tiranë, qoftë nëpërmjet njoftimeve në mediat sociale zyrtare, qoftë përmes telefonit, e-mailit etj. Është në të drejtën e secilës media që të jetë e pranishme ose jo në aktivitetet publike të Bashkisë së Tiranës.

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Medias dhe Komunikimit dhe numri i punonjësve të kësaj strukture është si më poshtë:

NR	Emertesa	Nr.Punonjesve
I	DREJTORIA E PERGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT	1+24
1	DREJTORIA E E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT	1+7
1.1	SEKTORI I MARREDHENIEVE ME MEDIAT	1+2
1.3	SEKTORI I MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN	1+3
2	DREJTORIA E MONITORIMIT TE MEDIAS	1+5
3	DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DIXHITAL	1+9

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju urojmë ditë të mbarë.

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Bashkia Tiranë